



FEDERATA  
SHQIPTARE E  
FUTBOLLIT



# RREGULLORE E INFRASTRUKTURËS

# 2025





FEDERATA SHQIPTARE E FUTBOLLIT

# RREGULLORE E INFRASTRUKTURËS

# 2025

# PËRMBAJTJA


---

<b>I – DISPOZITA TË PËRGJITHSHME</b>	6
NENI 1 - FUSHA E ZBATIMIT	6
NENI 2 - LIDHJA ME RREGULLORET E GARAVE	7
NENI 3 - PËRGJEGJËSITË E FSHF	7
NENI 4 - PËRKUFIZIMI I TERMAVE	8
<b>II – ZONAT QË LIDHEN ME LOJTARËT DHE ZYRTARËT</b>	9
NENI 5 - FUSHA E LOJËS	9
NENI 6 - ZONA E NXEMJES	10
NENI 7 - PORTAT DHE PORTAT REZERVË	11
NENI 8 - STOLAT E LOJTARËVE ZËVENDESIJES	12
NENI 9 - SHTIZAT E FLAMUJVE	13
NENI 10 - DHOMAT NE ZONËN E KOMPETICIONIT	13
NENI 11 - DHOMAT E ZHVEHJES PËR SKUADRA DHE ARBITRA	13
NENI 12 - DHOMA E DELEGATËVE	16
NENI 13 - DHOMA E EMERGJENCAVE MJEKËSORE PËR LOJTARËT DHE ZYRTARËT	17
NENI 14 - STACIONI I KONTROLLIT TË DOPINGUT	17
NENI 15 - HAPËSIRA PARKIMI PËR EKIPET DHE ZYRTARËT	17
NENI 16 - PROJEKTORËT E NDRIÇIMIT	18
<b>III – ZONAT E SPEKTATORËVE</b>	20
NENI 17 - KAPACITETI I SPEKTATORËVE PËR NDESHJET E UEFA & FSHF	20
NENI 18 - TRIBUNAT DHE AMBIENTET PËR SPEKTATORËT	21
NENI 19 - AMBIENTET SANITARE PËR SPEKTATORET	22
NENI 20 - AMBIENTET E NDIHMËS SË PARË PËR SPEKTATORËT	23
NENI 21 - RRRUGËT PËR HYRJET, DALJET DHE QARKULLIMIN E PUBLIKUT	23
NENI 22 - SISTEMI I NDRIÇIMIT TË EMERGJENCË	24
NENI 23 - SISTEMI I ADRESIMIT TË PUBLIKUT	25

# PËRMBAJTJA

---

NENI 24 - AMBIENTET PËR SPEKTATORËT ME AFTËSI NDREYSHJE	25
NENI 25 - VENDET PËR VIP DHE ZONA E PRITJES	27
NENI 26 - VENDET E PARKIMIT PËR VIP-AT, TË FTUARIT E TJERË DHE STAFIN	28
NENI 27 - DHOMAT E KONTROLLIT	29
NENI 28 - SISTEMI TELEVIZIV ME QARK TË MBYLLUR (CCTV)	30
<b>IV - ZONA PËR TRANSMETUESIT DHE MEDIAT</b>	<b>31</b>
NENI 29 - ZONA KU PUNOJNË MEDIAT	31
NENI 30 - ZONA KU PUNOJNË FOTOGRAFËT	32
NENI 31 - ZONA KU ULEN MEDIAT	32
NENI 32 - POZICIONET E KOMENTATORËVE TELEVIZIV	33
NENI 33 - PLATFORMAT E KAMERAVE	34
NENI 34 - STUDIOT TELEVIZIVE	36
NENI 35 - POZICIONET E INTERVISTAVE FLASH	36
NENI 36 - ZONA E AUTOBUZËVE PËR TRANSMETIME (O.B.VAN)	37
NENI 37 - SALLA E KONFERENCAVE PËR SHTYP	38
NENI 38 - ZONA PËR PËRDORIM TË NDREYSHËM (MIKS ZONE)	38
<b>V - DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE</b>	<b>39</b>
NENI 39 - MOSRESPEKTIMI	39
NENI 40 - SHTOJCAT	39
NENI 41 - ZBATIMI	39
NENI 42 - MIRATIMI, HYRJA NË FUQI DHE SHFUQIZIMI	39
<b>SHTOJCA A - PËRLLGARITJA E NDRIÇIMIT MESATAR TË PROJEKTORËVE</b>	<b>41</b>
A.1 PËRKUFIZIMET E TERMAVE	41
A.2 TESTIMI	42
<b>SHTOJCA B - ORGANIZIMI I FUSHËS</b>	<b>43</b>
<b>SHTOJCA C - PËRMASAT E INFRASTRUKTURËS SË EKIPEVE U7-U19 (Amator &amp; Profesionist)</b>	<b>44</b>




# I - Dispozita të përgjithshme



## Neni 1 - FUSHA E ZBATIMIT

- 1.1** Kjo rregullore zbatohet sa herë që referohet shprehimisht nga rregulloret specifike që rregullojnë garat e organizuara nga FSHF.
- 1.2** Kjo rregullore përcakton kriteret minimale strukturore që duhet të përmbushen nga një stadium në mënyrë që ai të klasifikohet (në rend klasifikimi në rritje) si kategoria 1, 2, 3 ose 4 të FSHF dhe UEFA-s. Sa më e lartë të jetë kategoria, aq më i rreptë është plotësimi i kriteve. Kriteret strukturore të zbatueshme për kategori të veçanta paraqiten në formën e tabelave që tregojnë shkallëzimin e kriteve midis kategorive të ndryshme. Kriteret strukturore që nuk paraqiten në formën e tabelave, vlejnë për të gjitha kategoritë.
- 1.3** Kjo rregullore përcakton përgjegjësitë për monitorimin e përputhshmërisë me kriteret strukturore për kategorinë e kërkuar të stadiumit dhe specifikon kushtet sipas të cilave administrata e FSHF-se mund të bëjë përjashtim nga një kriter specifik strukturor.
- 1.4** Kjo rregullore nuk prek detyrimet ligjore që rrjedhin nga legjislati kombëtar i zbatueshëm për stadiumet.

## Neni 2 - LIDHJA ME RREGULLORET E GARAVE



- 2.1** Rregulloret përkatëse të garave të FSHF:
- a.** specifikojnë kategorinë minimale të stadiumit të kërkuar për ndeshjet në garën përkatëse;
  - b.** mund të përcaktojnë kriteret strukturore të mëtjeshme dhe/ose më të rrepta për kategorinë e kërkuar krahasuar me ato të përcaktuara në këto rregulle.

## Neni 3 - PËRGJEGJËSITË E FSHF

- 3.1** FSHF, është përgjegjëse për:
- a.** inspektimin e çdo stadiumi, fushe stërvitore apo fushe loje dhe vlerësimin nëse ato plotësojnë kriteret strukturore të kategorisë së kërkuar;
  - b.** inspektimin e tribunave dhe ambienteve të tjera (sistemin e ndriçimit të emergjencës, ambientet e ndihmës së parë, mbrojtja nga ndërhyrjet e spektatorëve në zonën e lojës, etj.), në bashkëpunim me autoritetet publike kompetente me qëllim që stadiumet të plotësojnë të gjitha kërkesat e sigurisë të përcaktuara në legjislacionin kombëtar në fuqi.
  - c.** Këto inspektime FSHF është e detyruar t'ia beje te ditur UEFA-s sipas kërkesave të saj në sistemin TIME.
- 3.2** FSHF, përmes komisionit të Liçencimit, merr vendime që stadiumet të përdoren në bazë të formës dhe konfirmimit të mësipërm, dhe në bazë të çdo informacioni tjetër në dispozicion. Këto vendime janë të formës së prerë.
- 3.3** Administrata e FSHF-se mund të inspektojë stadiumet në çdo kohë para dhe gjatë garave për të cilën po përdoret stadiumi, për të kontrolluar nëse janë përmbushur kriteret e kërkuara strukturore.
- 3.4** FSHF, përmes komisionit të Licensimit, mund të lejojë ose të përjashtojë një kriter strukturor specifik në raste të vështirësive specifike dhe me kërkesë të arsyetuar, për shembull në përputhje me legjislacionin kombëtar në fuqi ose nëse përmbushja e të gjitha kritereve të kërkuara do të detyronte një klub anëtarë ose pjesëmarrës në aktivitetet e organizuara nga FSHF të zhvillojë ndeshjet në një stadium të një qyteti tjetër. Përjashtimet bëhen gjithmonë për një periudhë të kufizuar kohe. Këto vendime janë të formës së prerë.

**3.5** Pronari dhe operatori i stadiumit duhet të bëjnë çdo përpjekje të arsyeshme për të siguruar që infrastruktura e stadiumit të përmbushë standardet më të larta të mundshme të qëndrueshmërisë. Inkurajohen përpjekjet, në veçanti, për të optimizuar:

- » përdorimin e energjisë dhe ujit;
- » menaxhimin e mbetjeve.

## **Neni 4 - PËRKUFIZIMI I TERMAVE**

**4.1** Për qëllimet e kësaj rregullore, zbatohen përkufizimet e mëposhtme:

**Testi rezervë:** një simulim i ndërprerjes së energjisë elektrike në një zonë ose sistem të caktuar. Qëllimi parësor është vlerësimi i qëndrueshmërisë së energjisë elektrike p.sh. një gjenerator rezervë. Ndihmon në identifikimin e dobësive në infrastrukturën e energjisë dhe siguron që sistemet rezervë janë të afta të mbajnë operacione kritike gjatë një skenari real të ndërprerjes.

**Testi i ndërprerjes së energjisë:** Kryerja e një testi për ndërprerjen e energjisë në të gjithë ambientin. Testi përfshin ndërprerjen e qëllimshme të furnizimit me energji të plotë të ndërtesës për të vlerësuar funksionalitetin e sistemit të ndërtesës si ndriçimi me prozektore nën humbje të plotë të energjisë.


**Zona e garës:** Fushat teknike siç përcaktohet në Ligjet e Lojës IFAB dhe të gjitha zonat që përdoren kryesisht nga lojtarët dhe ekipi i arbitrave, si dhe zyrtarët dhe anëtarët e ekipit të vendit organizator të ndeshjes, plus pozicioni i zyrtarit të katërt, çdo ulëse në tribuna të përdorura nga delegacioni sportiv i secilit ekip, zona e shqyrtimit të gjyqtarëve (VAR) nëse përdoret, dhoma e gjyqtarëve dhe dhoma e ekipit mjekësor, dhoma e gjyqtarëve dhe dhoma e ekipit. stacioni i kontrollit të dopingut.

**IFAB:** Bordi i Federatës Ndërkombëtare të Futbollit;

**Kapaciteti spektatorëve:** Të gjitha vendet dhe vendet e caktuara në këmbë në stadium që janë në përputhje me këto rregullore, minus çdo ulëse të caktuar përgjithmonë për mediat dhe transmetuesit.

**VIP:** persona shumë të rëndësishëm të ftuar për të parë ndeshjen nga organizatori i saj.

**4.2** Në këtë rregullore, përdorimi i termave gramatikore në gjininë mashkullore i referohet në mënyrë të barabartë edhe gjinisë femërore.



## II - Zonat që lidhen me Lojtarët dhe Zyrtarët

### Neni 5 - FUSHA E LOJËS

**5.1** Fusha e lojës duhet të jetë e sheshuar e niveluar dhe në përputhje me Ligjet e Lojës së IFAB. Sipërfaqja e saj duhet të jetë e gjelbër dhe vijëzimi me ngjyrë të bardhë.

KATEGORIA	GJATËSIA	GJERËSIA	KËRKESA SHITESË
1	100–105m	64–68m	Nuk zbatohet
2–3 dhe 4	105m	68m	Ngrohja e fushës ose mbulesa e fushës (në varësi të vendndodhjes dhe kushteve klimatike).

**5.2** Asnjë vijë tjetër përveç vijave të futbollit, siç përcaktohet në Ligjet e Lojës së IFAB, nuk duhet të jetë e dukshme në fushën e lojës.

**5.3** Fusha e lojës duhet të jetë plotësisht e mbuluar me një sipërfaqe natyrale për lojë (100% bar natyral), bar natyral të përforcuar (hibrid) ose bar artificial për futboll (100% fibra artificiale).

**5.4** Terreni me bar artificial për futboll duhet:

- a. të jetë i pajisur me certifikatat e nevojshme të FIFA-s, të cilat mund të jepen vetëm pasi bari në fjalë të jetë testuar nga një laborator i akredituar i FIFA-s dhe të konfirmohet se përmbush standardet më të fundit të FIFA-s;
- b. të ketë një certifikatë të vlefshme FIFA Quality ose Quality Pro që plotëson kërkesat e kompeticionit në kohën e përcaktimit të stadiumit dhe për kohëzgjatjen e sezonit të garave;

- 5.5** Stadiumet duhet të ndërtohen dhe pajisen në mënyrë të tillë që në fushën e lojës të luhet gjatë të gjitha ditëve të ndeshjeve në sezonin e garave të FSHF.
- 5.6** Është e ndaluar zhvillimi i seancave stërvitore në të gjithë stadiumet dhe fushat sportive në të cilat skuadrat zhvillojnë ndeshjet zyrtare. Shkelja e kësaj dispozite do të jetë subjekt i dënimeve nga Komisioni i Disiplines dhe Etikes.
- 5.7** Asnjë objekt nuk duhet të jetë i vendosur më pak se 21 metra mbi fushën e lojës.
- 5.8** Zona në afërsi të drejtpërdrejtë me fushën e lojës duhet të jetë e sigurt për lojtarët, arbitrat dhe zyrtarët. Çdo element strukturor ose pajisje fikse buzë fushës duhet të vendoset të paktën 3 m nga shenjat e vijës, siç përcaktohet në shtojcën A, dhe të paktën 1 m nga pjesa e pasme e rretës së portës.
- 5.9** Pas çdo reklame duhet të ketë të paktën 2 metra hapësirë operative për të mundësuar zhvillimin e operacioneve në fushë, si kapja e topave nga fëmijët, lëvizja e stjuardëve, fotografëve, kamerave dhe operatorëve të tyre. Nëse kjo hapësirë nuk është e mjaftueshme në fushë, kamerat dhe operatorët mund të vendosen në tribuna.

## **Neni 6 - ZONA E NXEMJES**


---

- 6.1** Duhet të përcaktohen dy zona nxemjeje për lojtaret zëvendësues, një për çdo ekip, në të njëjtën anë të fushës së stolit të ekipit përkatës. Zonat e nxemjes duhet të jenë me terren natyral ose artificial, idealisht i njëjtë me fushën e lojës. Të dy zonat e nxemjes duhet të kenë të njëjtën sipërfaqe dhe të kenë të njëjtën madhësi, secila me përmasa 4m x 20m ose 3m x 25m për të akomoduar pesë lojtare zëvendësues dhe një trajner për secilin ekip, të gjithë në të njëjtën kohë. Nëse hapësira të tilla nuk janë të disponueshme në të njëjtën anë të fushës së stolit përkatës të ekipit, duhet të parashikohet një zgjidhje pas portave, pas tabelave reklamuese (nëse janë të instaluar).

**6.2** Në stadiumet ku zonat e nxemjes së zëvendësuesve janë ngjitur me fushën e lojës, korridori i sigurisë kërkohet menjëherë pas vijës së kontaktit. Në parim, duhet të jetë të paktën 1 m e gjerë dhe e vijeuar si më poshtë:

- » duke përdorur një vijë të ndërprerë (50 cm vija të ndara 1 m larg njëra-tjetrës) në një nuancë diskrete të të njëjtën ngjyrë si sipërfaqja në të cilën është pikturuar;
- » nga buza e zonës teknike deri te flamuri i këndit.

**6.3** Terreni artificial i përdorur për zonat e nxemjes duhet të jetë i një cilësie të lartë, i mirëmbajtur dhe fiksuar mirë në tokë.



## Neni 7 - PORTAT DHE PORTAT REZERVË

**7.1** Portat duhet të jenë prej alumini ose material i ngjashëm, të jenë të rrumbullakëta ose eliptike dhe të mos përbëjnë asnjë rrezik për lojtarët. Gjithashtu, ato duhet të jenë në përputhje me Ligjet e lojës së IFAB, që do të thotë, veçanërisht, që:

- a. distanca midis pjesës së brendshme të shtyllave duhet të jetë 7.32 metra;
- b. distanca nga skaji i poshtëm i skeletit deri në tokë duhet të jetë 2.44 metra;
- c. shtyllat e portës dhe skeleti duhet të jenë të bardha dhe të kenë të njëjtën gjerësi dhe thellësi, që nuk duhet të jenë më shumë se 12 cm;
- d. portat duhet të fiksohen fort në tokë.

**7.2** Çdo shtyllë shtesë që mbështet rrjetën e portës (shtyllat e rrjetës së portës) duhet të jetë pozicionuar në një kënd 45 gradë në lidhje me këndet e pasme të rrjetës dhe, ku është e mundur, në një distancë prej të paktën 2 m nga pjesa e pasme e saj. Nëse pozicionohet ndërmjet vijës së portës dhe reklamave, shtyllat duhet të mbulojnë me një mbushje material të paktën 4 cm të trashë, për të shmangur dëmtimin e lojtarëve ose krijimin e një rreziku sigurie, dhe të jetë një ngjyrë uniforme jo e bardhë.

### 7.3 Portat (duke përfshirë dhe atë rezervë) duhet të plotësojnë kërkesat e mëposhtme:

KATEGORIA 1	Nuk ka
2-3 dhe 4	Asnjë element strukturor shtesë apo mbështetje fizike nuk mund të përdoret brenda rrjetës ose pranë saj, përveç shufrave që fiksojnë rrjetën e portës në tokë dhe mbështetëset e rrjetës së portës prapa dhe jashtë rrjetës. Portat e lëvizshme nuk mund të përdoren në ndeshje zyrtare.

### 7.4 Të paktën një portë rezervë, e cila mund të instalohet lehtë nëse kërkohet nga rrethanat duhet të jetë e disponueshme brenda stadiumit.

## Neni 8 - STOLAT E LOJTARËVE ZËVENDËSUES

- 8.1** Stadiumet duhet të jenë të pajisura me dy bankina për ekipet, të vendosura në të dyja anët e vijës anesore në gjysmëfushat respektive, paralele me vijën anesore, secila me ndenjësë për të paktën 20 persona dhe pozicionuar të paktën 4 m larg nga vija anesore, me një pamje të papenguar të të gjithë fushë loje. Të gjitha vendet duhet të jenë të mbuluara dhe të ndara në mënyrë të përshtatshme nga publiku i gjerë.
- 8.2** Nëse stolat e ekipeve ofrojnë më pak vende se sa kërkohet nga rregullorja, e gares, vendet e mbetura duhet të vendosen në anën e secilit stol (ose prapa nëse stolat e ekipit janë në tribuna), me akses në dhomat e veshjeve. Ato duhet të ndahen nga publiku i gjerë dhe, në mënyrë ideale, të mbulojnë. Konfigurimi duhet të jetë i njëjtë për të dyja skuadrat.
- 8.3** Çdo zonë teknike dhe shenjat e saj duhet të jenë në përputhje me ligjet e lojës IFAB.
- 8.4** Midis stolave të ekipeve, duhet të sigurohet një pozicion me një vend dhe një tavolinë për gjyqtarin e katërt dhe zyrtaret e ndeshjes, në nivelin e fushës, i ndarë nga publiku i gjerë dhe i mbuluar. (minimumi me tre vende).

## Neni 9 - SHITIZAT E FLAMUJVE

---

**9.1** Stadiumet duhet të jenë të pajisura me të paktën pesë shtiza flamuri ose një strukturë tjetër të përshtatshme ku të valëviten pesë flamuj.

## Neni 10 - DHOMAT NE ZONËN E KOMPETICIONIT

---

**10.1** Në parim, të gjitha hapësirat nga neni 11 deri në nenin 14 duhet të jenë në të njëjtën ndërtesë, afër njëra me tjetrën dhe pranë tunelit të lojtarëve, duke i dhënë akses për në stolat e ekipit.

**10.2** Të gjitha këto hapësira duhet të jenë të pastra, të ndriçuara mirë, të ajrosura, të ngrohura, të pajisura qartë me shenjat e duhura dhe me sinjal Wi-Fi.

## Neni 11 - DHOMAT E ZHVESHJES PËR SKUADRAT DHE ARBITRAT

---

**11.1** Stadiumi duhet të jetë i pajisur me të paktën një dhomë zhveshjeje për çdo ekip, me zona të veçanta për lojtarët, zyrtarët e ekipit, fizioterapinë dhe ruajtjen. Dhomat e zhveshjes së skuadrave dhe arbitrave duhet të jenë të pajisura secila me:

- » dush me ujë të nxehtë,
- » lavaman
- » letër higjienike,
- » Mbajtëse sapuni ose shampo,
- » tharëse flokësh;

dhe duhet të plotësojnë kërkesat minimale specifike të mëposhtme:

## KATEGORIA 1-2

<b>Mjedise për ndenjëse dhe varje rrobash ose dollapë</b>	-26 persona	60m <sup>2</sup>
<b>Objekte sanitare</b>	5 dushe- 2 tualete me ndenjese te vecanta	
<b>Fizioterapia</b>	1 tavolinë masazhi	
<b>Ne ambientin e perbashket</b>	1 frogorifer i madh	
	1 monitor per projektim ose table taktike	
<b>Hapesire per magazinim</b>	1 tavolinë dhe/ose hapësirë ruajtjeje të lirë	5m <sup>2</sup>

## KATEGORIA 3-4

<b>Mjedise për ndenjëse dhe varje rrobash ose dollapë</b>	-23 persona	55m <sup>2</sup>
<b>Objekte sanitare</b>	6 dushe- 3 tualete me ndenjese te vecanta	
<b>Fizioterapia</b>	3 tavolinë masazhi	15 m <sup>2</sup>
<b>Ne ambientin e perbashket</b>	1 frogorifer i madh	
	1 monitor per projektim ose table taktike	
<b>Hapesire per magazinim</b>	1 tavolinë dhe/ose hapësirë ruajtjeje të lirë	5m <sup>2</sup>

## ZONA E NDËRRIMIT PER ZYRTARET E EKIPIT

Mjedise për ndenjëse dhe varje rrobash ose dollapë për zyrtarët e ekipit	7 persona	20m <sup>2</sup>
	1 tavolinë +2 karrige	

**11.2** Stadiumet duhet të pajisen me dhomë zhveshje për arbitrat kryesore, e cila duhet të plotësojë kërkesat e mëposhtme:

KATEGORIA	INSTALIMET	DIMENSIONET E REKOMANDUARA SANITARE
	Objektet	
	2 dushe	
	1 tualet me ndenjëse te veçante	

PËR TË GJITHA KATEGORITË	
Zona ne ndryshim:	20 m <sup>2</sup>
1 frigorifer	
1 tavoline	
2 karrige	
Ambjente ndenjese dhe varese rrobash ose dollape per 6 persona	

**11.3** Stadiumi duhet të ketë, një dhomë shtesë veshjeje e cila duhet të jete pranë dhomës se zhveshjes se arbitreve kryesore ( e aplikueshme ne rastet kur trupa e arbitrave është e përberë nga te dy gjinite). Kjo dhomë duhet të përmbushë kërkesat minimale si:

KATEGORIA	INSTALIMET	DIMENSIONET E REKOMANDUARA
	Objektet	
Per te gjitha kategorite	1 dush	
	1 tualet me ndenjëse te veçante	
	1 Frigorifer te madh	
	1 tavoline, 2 karige, Ambjente ndenjese dhe varese robash ose dollape per 2 persona	

**11.4** Stadiumet duhet të garantojnë qasje të drejtpërdrejtë, private dhe të sigurt për të dyja skuadrat dhe gjyqtarët nga dhomat e tyre të zhveshjes për në fushën e lojës.

## Neni 12 - DHOMA E DELEGATËVE

**12.1** Stadiumet duhet të pajisen me një dhomë që është e rezervuar ekskluzivisht për delegatin e FSHF & UEFA-s dhe vëzhguesin e arbitrave (nëse ka), me një akses të thjeshte për në dhomat e zhveshjes së skuadrave dhe gjyqtarëve.

## **Neni 13 - DHOMA E EMERGJENCAVE MJEKËSORE PËR LOJTARËT DHE ZYRTARËT**

---

**13.1** Stadiumet duhet të jenë të pajisura me një dhomë për emergjenca mjekësore siç përcaktohet në Rregulloret Mjekësore të UEFA-s & rregulloret e FSHF-së.

## **Neni 14 - STACIONI I KONTROLLIT TË DOPINGUT**

---

**14.1** Stadiumet duhet të jenë të pajisura me një stacion të veçantë të kontrollit të dopingut siç përcaktohet në Rregulloret Mjekësore të UEFA-s & FSHF.

## **Neni 15 - HAPËSIRA PARKIMI PËR EKIPET DHE ZYRTARËT**

---

**15.1** Vendet e parkimit për të paktën dy autobusë tre furgona dhe shtatë vetura duhet të jenë të disponueshme për ekipet dhe zyrtarët në një zonë të sigurt dhe të mbrojtur në afërsi të hyrjes së lojtarëve dhe zyrtarëve. Nëse ky parkim nuk ndodhet në afërsi të hyrjes së lojtarëve dhe zyrtarëve, duhet të organizohet një zonë e sigurt dhe e mbrojtur ku ata të zbresin.

## Neni 16 - PROJEKTORËT E NDRIÇIMIT

**16.1** Stadiumet duhet të jenë të pajisura me një sistem ndriçimi që lejon ruajtjen e të paktën ndriçimit mesatar te mëposhtëm, i matur sipas Udhëzuesit të Ndrriçimit të UEFA-s:


KATEGORIA	NDRIÇIMI HORIZONTAL	NDRIÇIMI VERTIKAL
1	<b>350</b> lux ose Mjaftueshëm për të lejuar transmetuesin të garantojë transmetimin e duhur të ndeshjes.	
2	<b>800</b> Eh(lux) me shkallë njëtrajtshmërie U1h> 0.4 dhe U2h >0.6	<b>350</b> Ev(lux) në secilin plan referencë me shkallë njëtrajtshmërie U1 >0.35 dhe U2 >0.45
3	<b>1 200</b> Eh(lux) me shkallë njëtrajtshmërie U1h> 0.4 dhe U2h >0.6	<b>700</b> Ev (lux) në secilin plan referencë me shkallë njëtrajtshmërie U1 >0.35 dhe U2 >0.45
4	<b>1 400</b> Eh(lux) me shkallë njëtrajtshmërie U1h> 0.5 dhe U2h >0.7	<b>1 000</b> Ev (lux) në secilin plan referencë me shkallë njëtrajtshmërie U1 >0.4 dhe U2 >0.5

**16.2** Sistemi i prozhektorëve të stadiumit duhet të mirëmbahet rregullisht për të përmbushur kërkesat, vlerat minimale të ndriçimit. Një certifikatë ndriçimi që vlen për të gjithë periudha e konkurrimit, duhet të lëshohet jo më shumë se një vit përpara datës së ndeshjes se parë të ekipit vendas në kompeticionin e FSHF-se & UEFA-s.

**16.3** Gjithashtu, përveç kësaj, për të siguruar vazhdimin e ndeshjeve edhe në rast të ndërprerjes së energjisë, duhet të sigurohet furnizimi me energji rezervë, te pavarur, i cili duhet të jetë i disponueshëm dhe në gjendje që të sigurojë të paktën ndriçim mesatar horizontal si më poshtë:

KATEGORIA	PËR NDESHJET E LUAJTURA NËN DRITAT E PROJEKTORËVE	PËR NDESHJET QË TRANSMETOHEN
1	Nuk zbatohet	Nuk zbatohet
2	350 Eh(lux)	350 Eh(lux)
3		800 Eh(lux)
4		900 Eh(lux) jo më shumë se 15 minuta pas ndërprerjes së energjisë elektrike.

**16.4** Një test rezervë i fuqisë së ndriçimit duhet të kryhet të paktën një herë në vit. Sistemet e emergjencës së Stadiumit duhet të jenë plotësisht funksionale dhe të jenë në përputhje me normat dhe standardet e sigurisë. Për të verifikuar funksionimin e saktë të të gjithë sistemit në stadium, rekomandohet një test i plotë çdo katër vjet.



## III - Zonat e Spektatorëve

### **Neni 17 - KAPACITETI I SPEKTATORËVE PËR NDESHJET E UEFA & FSHF**

**17.1** Stadiumet duhet të kenë kapacitetin minimal të shikuesve të FSHF- & UEFA-s, siç përcaktohet në Paragrafin 4.01:

1	<b>200</b> ulëse per spektatorë
2	<b>1,500</b> ulëse
3	<b>4,500</b> ulëse
4	<b>8,000</b> ulëse

**17.2** Të paktën 5% e kapacitetit të spektatorëve në ndeshjet e FSHF & UEFA-s duhet të vihet në dispozicion për tifozet miq në një sektor të dedikuar të stadiumit. Duhet që ky sektor i stadiumi të ndahet nga sektorët e tjerë dhe të gjitha objektet përkatëse dhe shërbimet (p.sh. sanitare, katering, ndihma e parë) duhet të jenë të disponueshme ekskluzivisht për tifozet miq, të aksesueshëm dhe në funksion për aq kohë sa kanë tifozet miq te kene qasje në stadium.

## Neni 18 - TRIBUNAT DHE AMBIENTET PËR SPEKTATORËT

**18.1** Vendet ku ulen spektatorët duhet të jenë individuale, të pajisura me numra, të fiksuara fort në vend, të forta, të përbëra nga material i papërshkueshëm nga uji dhe nga material jo i ndezshëm, dhe të kenë një mbështetëse me lartësi të paktën 30 cm kur maten nga sipërfaqja e ulëses.

**18.2** Ulëset duhet të jenë të fiksuara në një themel mbajtës dhe nuk mund të mbështeten apo të përmbajnë ndonjë strukturë me tuba/skela. Materiali, dizajni dhe konstruksioni i ulëseve duhet të jenë të destinuara qartë për përdorim të përhershëm

**18.3** Për qëndrimin në këmbë, tarraca, platforma, stolat dhe ulëset pa mbështetëse veprohet si më poshtë:

KATEGORIA	
1	Lejohet me kusht që stolat dhe ulëset pa mbështetëse të jenë të fiksuara fort ne vend
2 deri në 4	E ndaluar

**18.4** Stadiumet duhet të jenë në gjendje të mirë dhe të gjitha zonat duhet të jenë të pastra dhe të ndriçuara mirë.

Nuk duhet të ketë asnjë material të lirshëm (p.sh. gurë, beton) që mund të jetë i rrezikshëm, i hedhur ose i keqpërdorur ndryshe.

**18.5** Zonat e spektatorëve duhet të sigurojnë pamje të papenguara të shikimit të fushës së lojës.

**18.6** Mjediset e kateringut duhet të jenë të disponueshme në çdo sektor, të jenë të aksesueshme dhe të qëndrojnë të hapura për aq kohë sa spektatorët të kenë akses në sektor. Çmimet e kateringut për mbështetësit vizitorë nuk duhet të kalojnë ato për mbështetësit në shtëpi.

## **Neni 19 - AMBIENTET SANITARE PËR SPEKTATORET**

**19.1** Një numër i mjaftueshëm ambientesh sanitare të përhershme, të pastra dhe higjienike duhet të jenë të disponueshme në çdo sektor, të aksesueshme dhe të shpërndara në mënyrë të barabartë në të gjithë sektorët, me një minimum prej 25% të ambienteve sanitare të dedikuara për spektatorët femra. Ambientet sanitare duhet të funksionojnë për aq kohë sa spektatorët të kenë akses në stadium. Këto zona duhet të jenë të ndritshme, të pastra dhe higjienike dhe të mbahen në atë gjendje gjatë çdo dite ndeshjeje.

Objektet sanitare duhet të jenë të pajisura me:

- » tualete
- » Lavamane me ujë të pastër;
- » peshqirë dhe/ose tharëse duarsh
- » vend për mbajtësen e sapuneve të fiksuara fort në vend;

**19.2** Stadiumet duhet të jenë në gjendje të sigurojnë që 80% e spektatorëve të jenë meshkuj, duke respektuar raportet minimale të mëposhtme:

- » 1 tualet ulur dhe 1 lavaman për 250 spektatorë meshkuj;
- » pishuare për 125 spektatorë meshkuj.

Në të njëjtën kohë, për të lejuar ndryshime në demografinë ndërmjet ndeshjeve, stadiumet duhet të jenë në gjendje të sigurojnë që të paktën 25% e spektatorëve të jenë femra, duke respektuar raportet minimale të mëposhtme:

- » 1 tualet ulur dhe 1 lavaman për 120 spektatore femra në sektorët e shtëpisë;
- » 1 tualet ulur dhe 1 lavaman për 80 spektatore femra në sektorin e vizitorëve.

Gjithashtu duhet t'i kushtohet vëmendje akomodimit të gjinive të ndryshme.

## **Neni 20 - AMBIENTET E NDIHMËS SË PARË PËR SPEKTATORËT**

---

- 20.1** Ambiente të ndihmës së parë të pajisura plotësisht, të miratuara nga autoritetet kompetente lokale duhet të jenë të disponueshme në çdo sektor, të jenë të aksesueshme dhe të qëndrojnë në funksion për aq kohë sa spektatorët të kenë akses në sektor. Ambientet e ndihmës së parë në sektorët e pajisur me ambiente për spektatorët me aftësi të ndryshe duhet të jenë të aksesueshme për të gjithë spektatorët.
- 20.2** Kërkesat minimale në lidhje me mjediset e ndihmës së parë për spektatorët janë dhënë në Kërkesat Minimale Mjekësore të UEFA-s për spektatorët.
- 20.3** Të gjitha ambientet e ndihmës së parë duhet të shënohen qartë dhe të pajisen me sinjalistikën e duhur.

## **Neni 21 - RRUGËT PËR HYRJET, DALJET DHE QARKULLIMIN E PUBLIKUT**

---

- 21.1** Rrugët hyrëse për në stadium, hyrjet, daljet dhe të gjitha vendet publike brenda stadiumit duhet të shënohen qartë dhe të pajisen me sinjalistikën e duhur (për shembull me shkronja dhe numra) ose në formë të piktogrameve të njohura ndërkombëtarisht. Tabelat duhet të jenë të aksesueshme edhe për personat që nuk shikojnë. Udhëzimet mund të gjenden në Udhëzimet e Aksesueshmërisë së UEFA-s.
- 21.2** Portat e hyrjes dhe/ose portat rotulluese duhet të jenë të projektuara në atë mënyrë që të shmangen bllokimet, mbipopullimin dhe të sigurohet qarkullimi i mirë i spektatorëve.
- 21.3** Rregullat bazë që tregojnë sendet e ndaluara, idealisht në formën e piktogrameve të njohura ndërkombëtarisht, duhet të jenë të disponueshme në çdo hyrje.
- 21.4** Të gjitha rrugët e aksesit, hyrjes-daljes dhe qarkullimit të publikut duhet të dallohen qartë nga zonat e ulëseve. Portat e hyrjes, portat e daljes dhe dyert duhet të jenë funksionale dhe të tregohen me shenja, të cilat janë të kuptueshme në mënyrë universale.

**21.5** Të gjitha dyert dhe portat që janë pjesë e rrugëve të daljes ose evakuimit, dhe të gjitha portat që çojnë nga zonat publike në fushën e lojës (nëse ka), duhet:

- a) të jenë funksionale dhe të projektuara në mënyrë të tillë që të qëndrojnë të zhbllokuara (por me personel kontrolli) teksa spektatorët ndodhen në stadium;
- b) të hapen nga jashtë në drejtim të rrugëve të daljes dhe evakuimit.

**21.6** Gjithashtu, stadiumet duhet të plotësojnë kërkesat e mëposhtme në lidhje me kontrollet e aksesit:

KATEGORIA	KËRKESA SHITESË TË KONTROLLIT TË AKSESIT
1 -2	Nuk ka
3 dhe 4	Të gjitha hyrjet publike duhet të jenë të pajisura me tripode (porta rotulluese) dhe një sistem elektronik të kontrollit të biletave të projektuar për të parandaluar përdorimin e biletave të falsifikuara dhe për të siguruar të dhëna në kohë reale për fluksin e spektatorëve dhe numrin e hyrjes në një pikë qendrore, me qëllim parandalimin e mbipopullimit në stadium, në tërësi ose në sektorë të veçantë. Raporti duhet të jetë 1 tripod për 660 ulëse.

## Neni 22 - SISTEMI I NDRIÇIMIT TË EMERGJENCË

**22.1** Për qëllime të garantimit të sigurisë dhe drejtimit të spektatorëve dhe personelit në rast të një mosfunksionimi të përgjithshëm të ndriçimit, stadiumet duhet të pajisen me një sistem ndriçimi të emergjencës, i cili duhet të jetë miratuar nga autoritetet lokale kompetente dhe të mbulojë të gjitha zonat e stadiumit, duke përfshirë të gjitha rrugët e daljes dhe të evakuimit, i cili duhet të jetë i lidhur me një burim furnizimi me energji elektrike rezervë.

## **Neni 23 - SISTEMI I ADRESIMIT TË PUBLIKUT**

---

- 23.1** Stadiumet duhet të jenë të pajisura me një sistem elektronik të adresimit publik me altoparantë për të përcjellë mesazhe zanore njëkohësisht në të gjitha zonat e stadiumit. Sistemi audio i stadiumit duhet të lidhet me një furnizim rezervë me energji elektrike dhe me zë të lartë mjaftueshëm për t'u dëgjuar si brenda dhe jashtë stadiumit, në të gjitha rrethanat
- 23.2** Sistemi i adresimit publik duhet të mbulojë zonat brenda dhe jashtë stadiumit dhe të jetë i lidhur me një rrjet të pavarur të energjisë elektrike.

## **Neni 24 - AMBIENTET PËR SPEKTATORËT ME AFTËSI NDRYSHE**

---

- 24.1** Stadiumet duhet të kenë ambiente të dedikuara dhe akses, hyrje dhe dalje, rrugë plotësisht të aksesueshme, pikat e zbritjes, parkimi, vendkalimet, kabinat e biletave, ndenjëset dhe objekte për shikuesit me aftësi ndryshe dhe shoqëruesit e tyre.
- 24.2** Të gjitha vendet e aksesueshme duhet të ofrojnë një pamje të papenguar të fushës së lojës dhe të jenë të numërtuara qartë. Përveç kësaj, të gjitha hapësirat e karrigeve me rrota duhet të shënohen me shenjë ndërkombëtare të aftësisë ndryshe në dysheme dhe të kenë pranë një ndenjësë fikse për një shoqërues ose asistent personal. Udhëzimet mund të gjenden në Udhëzimet së UEFA-s, "Për aksesin".

**24.3** Stadiumet duhet të pajisen me hapësira të dedikuara për përdoruesit e karrigeve me rrota. Hapësira e rekomanduar për përdoruesit e karrigeve me rrota për tifozët vendas është 0.5% e kapacitetit të spektatorëve ne stadium gjate ndeshjeve të FSHF-se & UEFA-s të rezervuara për tifozët vendas, dhe kërkesa minimale është 0.1%. Kërkesa minimale për tifozët miq është siç përcaktohet në tabelën e mëposhtme. Kapaciteti i spektatoreve FSHF-së vendet për karriget me rrota për tifozët miq:

Më shumë se 200	<b>2</b>
201-1500	<b>4</b>
1501-4500	<b>6</b>
4501-8000	<b>8</b>
8001-20.000	<b>10</b>
20,001-30,000	<b>12</b>
30,001-40,000	<b>15</b>
40,001 and above	<b>20</b>

**24.4** Tifozët me aftësi ndryshe duhet të kenë mundësi të ulen ne sektorin e dedikuar për tifozerinë të cilës i përkasin. Nëse kjo nuk është e mundur, për tifozët miq me aftësi ndryshe, duhet t'u ofrohet një vend alternativ i sigurt.

**24.5** Stadiumet duhet të kenë ambiente ushqimi të aksesueshme në sektorë që përmbajnë ndenjëse për spektatorë me aftësi ndryshe.

**24.6** Mjediset e kateringut duhet të kenë korsi te dedikuar për spektatorët me aftësi ndryshe, duke siguruar akses deri në banak dhe lehtësira të përshtatshme.

**24.7** Stadiumet duhet të ofrojnë raportin minimal të mëposhtëm të përhershëm, të objekteve sanitare, të pastër, higjienik dhe ambiente sanitare plotësisht të aksesueshme për përdoruesit e karrigeve me rrota brenda stadiumit. Ambientet sanitare duhet të jetë jo më shumë se 40 m larg nga hapësirat e përdoruesve të karrigeve me rrota, brenda të njëjtin sektor dhe të jetë i pajisur plotësisht në përputhje me Udhëzimet e Aksesueshmërisë së UEFA-s.

1. Minimumi 1 për deri në 15 përdorues të karrigeve me rrota.

## **Neni 25 - VENDET PËR VIP DHE ZONA E PRITJES**

**25.1** Stadiumet duhet të kenë numrin minimal të mëposhtëm të vendeve ku ulen personat e rëndësishëm të veçantë (VIP):

Kat 1 -2	<b>50</b>
3	<b>75</b>
4	<b>100</b>

**25.2** Vendet VIP duhet të jenë të mbuluara dhe vendet e tyre duhet të jetë në tribunën kryesore, midis dy vijave të 16m, sa më afër vijës së mesit të fushës.

**25.3** Stadiumet duhet të jenë të pajisura me një zonë të dedikuar për pritjen e të ftuarve VIP, e cila duhet të jetë e lehtë për t'u aksesuar nga vendet ku ulen VIP.

**25.4** Zonat e mikpritjes dhe skyboxes duhet të jenë plotësisht të aksesueshme për përdoruesit e karrigeve me rrota.

## **Neni 26 - VENDET E PARKIMIT PËR VIP-AT, TË FTUARIT E TJERË DHE STAFIN**

**26.1** Stadiumet duhet të kenë numrin minimal të mëposhtëm të vendeve të parkimit për vetura në një zonë të sigurt dhe të mbrojtur për personat VIP, të ftuar të tjerë dhe stafin:

<b>KATEGORIA</b>	
1	<b>20</b>
2	<b>50</b>
3	<b>100</b>
4	<b>150</b>

**26.2** Stadiumet duhet të kenë hapësira adekuate dhe të mjaftueshme për vendqëndrim dhe parkim të spektatorëve me aftësi ndryshe dhe me lëvizshmëri të ulët, sipas rregullave të autoriteteve vendore.

## Neni 27 - DHOMAT E KONTROLLIT


**27.1** Një dhomë kontrolli duhet të rezervohet për stafin dhe zyrtarët të cilët janë përgjegjës për të gjitha çështjet e sigurisë, dhe shërbimeve që lidhen me ndeshjen, përkatësisht shefin e policisë, oficerin e sigurisë së stadiumit dhe stafin e tyre. Ato duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:

KATEGORIA	OBJEKTET KRYESORE	KËRKESA SHITESË
1	Nuk ka	Nuk ka
2	<p>Një sallë kontrolli që ofron një pamje të përgjithshme të pjesës së brendshme të stadiumit dhe e pajisur me komunikim në radio që mundëson komunikimin midis stafit dhe zyrtarëve përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen në stadium.</p> <p>Një sallë kontrolli që ofron një pamje të përgjithshme të pjesës së brendshme të stadiumit dhe e pajisur me komunikim në radio që mundëson komunikimin midis stafit dhe zyrtarëve përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen në stadium.</p>	Nuk ka
3 dhe 4	Një sallë kontrolli që ofron një pamje të përgjithshme të pjesës së brendshme të stadiumit dhe e pajisur me komunikim në radio që mundëson komunikimin midis stafit dhe zyrtarëve përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen në stadium	Salla e kontrollit duhet të jetë e pajisur me monitorë me ngjyra, të cilët janë të lidhur me sistemin televiziv me qark të mbyllur dhe monitorë shtesë që shfaqin të dhënat live nga sistemi elektronik i kontrollit të biletave.

## Neni 28 - SISTEMI TELEVIZIV ME QARK TË MBYLLUR (CCTV)

**28.1** Stadiumet duhet të plotësojnë kërkesat e mëposhtme në lidhje me sistemin televiziv me qark të mbyllur:

KATEGORIA:	
1-2	Nuk zbatohet
3 dhe 4	Sistemi televiziv me qark të mbyllur që përdor kamera vëzhgimi me ngjyra me funksione pan, pjerrtas dhe zmadhim, mbulon të gjitha qasjet dhe hyrjet e stadiumit, dhe të gjitha hapësirat publike brenda stadiumit. Zonat e brendshme të stadiumit që nuk mund të shihen drejtpërdrejt nga salla e kontrollit, duhet të mbulohen nga sistemi televiziv me qark të mbyllur. Kameran duhet të jete ne gjendje të regjistrojnë imazhe në lëvizje, si dhe fotografi fikse.



## IV - Zona për Transmetuesit dhe Mediat

### Neni 29 - ZONA KU PUNOJNË MEDIAT

**29.1** Stadiumet duhet të kenë të paktën një dhomë të pajisur me tavolina, nje furnizim me energji elektrike dhe lidhje interneti për t'u përdorur si ambient pune për përfaqësuesit e mediave.

**29.2** Ambienti i punës së mediave duhet të sigurojë minimumin e mëposhtëm të posteve të punës për përfaqësuesit e mediave.

#### Numri minimal i pozicioneve te medias:

KATEGORIA	
1	<b>10</b>
2	<b>20</b>
3 dhe 4	<b>30</b>

## Neni 30 - ZONA KU PUNOJNË FOTOGRAFËT

**30.1** Zona e punës për fotografët duhet të përmbajë tavolina, karrige dhe priza elektrike, të kenë lidhje në internet dhe ofrojnë qasje të drejtpërdrejtë në fushë, e cila mund të jetë një seksion i dedikuar i zonës së punës së medias (madhësia e përgjithshme e së cilës duhet të rritet në përputhje me rrethanat), por preferohet një dhomë e veçantë. Kjo zonë duhet të jetë në gjendje akomodojnë numrin minimal të vendeve të punës si vijon:

KATEGORIA	NUMRI MINIMAL I POSTEVE TË PUNËS
1-2	Nuk zbatohet
3	<b>15</b>
4	<b>20</b>

## Neni 31 - ZONA KU ULEN MEDIAT

**31.1** Stadiumet duhet të kenë një zonë të dedikuar në tribuna që është e rezervuar për shtypin e shkruar dhe komentuesit e radios. Ajo duhet të jetë e mbuluar dhe e vendosur në qendër (d.m.th. midis vijave 16 m), në mënyrë ideale në të njëjtën anë me platformën kryesore të kamerës, me një pamje të papenguar të gjithë fushës së lojës dhe afërsisë së saj të menjëhershme dhe akses të lehtë në zonat e tjera të medias.

**31.2** Gjithashtu, stadiumet duhet të plotësojnë kërkesat e mëposhtme në lidhje me vendin e mbuluar ku ulen mediat:

KATEGORIA	NUMRI MINIMAL I ULËSEVE	NUMRI MINIMAL I ULËSEVE TË PAJISURA ME TAVOLINA
1	<b>10</b>	<b>5</b>
2	<b>20</b>	<b>10</b>
3	<b>30</b>	<b>15</b>
4	<b>60</b>	<b>30</b>

**31.3** Secila tavolinë duhet të jetë aq sa të akomodojë një kompjuter laptop dhe e pajisur me furnizim me energji elektrike dhe lidhje interneti.

## Neni 32 - POZICIONET E KOMENTATORËVE TELEVIZIV

**32.1** Stadiumet duhet të kenë numrin minimal të pozicioneve të komentatorëve televiziv:

KATEGORIA	
1	<b>1</b> (vetëm për ndeshjet që po transmetohen)
2	<b>3</b>
3	<b>5</b>
4	<b>10</b>

- 32.2** Pozicionet e komentatorëve televizivë duhet të jenë të mbuluara dhe të pozicionuara në qendër midis dy vijave 16 metra, në të njëjtën anë me platformën kryesore të kamerave. Ata duhet të kenë një pamje të lirë të të gjithë fushës së lojës dhe rreth e rrotull saj, të kenë akses të lehtë në zonat e tjera të mediave dhe të jenë të sigurt dhe të aksesueshëm vetëm nga persona të autorizuar. Duhet të ketë hapësirë të mjaftueshme prapa ulëseve që edhe komentatorë të tjerë të levizin lirish në pozicionet e tyre.
- 32.3** Çdo post komentatori duhet të jetë i pajisur me një tavolinë minimumi 180 cm të gjatë, të paktën tre ulëse, një linjë telefonike, furnizim me energji elektrike, ndriçim dhe lidhje interneti.

## Neni 33 - PLATFORMAT E KAMERAVE

---

- 33.1** Për të siguruar cilësinë optimale të figurës, të gjitha platformat e kamerave duhet:
- » të jetë në nivel;
  - » të jetë solid;
  - » të jetë jo vibruese;
  - » të sigurojë një pamje të papenguar të gjithë fushës së lojës dhe afërsisë së saj;
  - » të jetë i mbuluar;
  - » të ketë një sipërfaqe të lëmuar, jo të rrëshqitshme në bazë;
  - » të jetë e sigurt dhe e qëndrueshme për akses;
  - » të ofrojnë mbrojtje nga të gjitha anët me një tabelë që është të paktën 75 mm e lartë.
- 33.2** Platforma kryesore e kamerës duhet të vendoset saktësisht në linjë me vijën e mesit të fushës, nga ana perëndimore e fushës. Duhet të pozicionohet në një lartësi mbi fushën që garanton një pamje optimale dhe të papenguar të gjithë fushës së lojës dhe afërsisë së saj dhe, në parim, kur fokusohet në pikën qendrore në fushë, të jetë në një kënd prej 12 deri në 15 gradë në krahasim me rrafshin horizontal.

**33.3** Përveç kësaj, platforma kryesore e kamerës duhet të plotësojë kërkesat e mëposhtme:

KATEGORIA	PLATFORMA KRYESORE E KAMERES
1.	Të paktën 2 m gjerësi x 2 m thellësi, për të akomoduar një kamerë (vetëm për ndeshjet që po transmetohen)
2 & 3	Të paktën 4 m gjerësi x 2 m thellësi, për të akomoduar dy kamera
4	Të paktën 6 m e gjerë x 2 m e thellë, për të akomoduar të paktën tre kamera

**33.04** Për kategoritë si ne vijim, kërkohen platforma shtesë kamerash:

KATEGORIA	PLATFORMA SHITESË E KAMERAVE
1 & 2	
3 & 4	Dy platforma kamerash 16m, të vendosura në të njëjtën anë dhe të paktën në të njëjtën lartësi me platformën kryesore të kamerës, secila me përmasa të paktën 2m e gjerë x 2m e thellë për të akomoduar një kamerë në linjën e 16m
4	Një platformë kamere me kënd të kundërt e vendosur në qendër në tribunën përballë kamerës kryesore, me përmasa të paktën 2m të gjerë x 2m të thellë për të akomoduar të paktën një kamerë

## Neni 34 - STUDIOT TELEVIZIVE

**34.1** Stadiumet duhet të jenë të pajisura me dhoma që plotësojnë kërkesat e mëposhtme dhe mund të përdoren si studio televizive, nëse kërkohet:

KATEGORIA	NUMRI MINIMAL I STUDIOVE	MADHËSIA MINIMALE	KËRKESA SHITESË
1-2	1 studio	5m e gjatë x 5m e gjerë x 2.5m e lartë	Nuk ka
3	2 studio	5m e gjatë x 5m e gjerë x 2.5m e lartë	Të paktën një nga dy studiot televizive duhet të jetë me një pamje të lirë të të gjithë fushës së lojës.
4			Të paktën një nga dy studiot televizive duhet të jetë me një pamje të lirë të të gjithë fushës së lojës.

## Neni 35 - POZICIONET E INTERVISTAVE FLASH

**35.1** Stadiumet duhet të jenë të pajisura me një zonë që ndodhet mes fushës dhe dhomave të zhveshjes që mund të përdoret për pozicionet e intervistave flash, ku mund të zhvillohen intervista live në TV dhe radio.

**35.2** Gjithashtu, zona e caktuar për pozicionet e intervistave flash duhet të plotësojë kërkesat e mëposhtme:

KATEGORIA	
1 dhe 2	Nuk aplikohet
3 dhe 4	Të jetë mjaftueshëm e madhe ku të vendosen të paktën katër pozicione për intervista, secili 4 metra i thellë dhe 3 metra i gjerë.

## Neni 36 - ZONA E AUTOBUZËVE PËR TRANSMETIME (O.B.VAN)

**36.1** Stadiumet duhet të kenë një zonë të sigurt që mund të përdoret si zonë parkimi për autobuzët/furgonat e transmetimit të kompanive televizive. Zona duhet të ketë të paktën përmasat e mëposhtme:

KATEGORIA	
1	<b>300</b> m <sup>2</sup>
2	<b>400</b> m <sup>2</sup>
3	<b>600</b> m <sup>2</sup>
4	<b>1,000</b> m <sup>2</sup>

**36.2** Zona e parkimit të autobusëve për transmetimin televiziv duhet:

- a. të jetë i vendosur pranë stadiumit, preferohet në të njëjtën anë me platformën e kamerës kryesore, dhe të ketë furnizim me energji elektrike në dispozicion.
- b. të sigurojë një zonë të pastër, të ngurtë dhe të sheshtë parkimi për automjete të mëdha dhe të rënda (d.m.th. kamionë 40 ton);
- c. të ketë sistem të mjaftueshëm kullimi në mënyrë që asnjë kablo, pajisje apo automjet të mos vendoset në rrezik kontakti me ujin e ndenjur;
- d. të mos ketë asnjë pengesë, si p.sh. pemë, ndërtesa dhe buzë trotuari, dhe të ofrojë akses të lirë për automjetet e urgjencës;
- e. të sigurojë një pamje të lirë, pa pengesa të horizontit nga jugperëndimi deri në juglindje, ose të jetë brenda një distance 50 metra nga një zonë e veçantë e lidhjes satelitore të ndarë më vete (e matur nga skaji i kompleksit të transmetimit).
- f. të ndriçohet në një ndriçim vertikal mesatar prej të paktën 100 luks për të mundësuar transmetuesit për të punuar natën;
- g. të përfshijnë objekte të mjaftueshme, si kosha plehrash dhe tualete.

## Neni 37 - SALLA E KONFERENCAVE PËR SHTYP

**37.1** Stadiumet duhet të plotësojnë kërkesat e mëposhtme për sa i përket sallave të konferencave për shtyp:


KATEGORIA	VENDNDODHJA DHE AMBIENTET	NUMRI MINIMAL I ULËSEVE
1	Nëse hapësira e lejon, salla e konferencave për shtyp duhet të jetë e vendosur brenda stadiumit. Ajo mund të jetë pjesë e zonës ku punojnë mediat.	Nuk ka
2	Brenda Stadiumit duhet të ketë një sallë për konferenca për shtyp. Ajo mund të jetë pjesë e zonës ku punojnë mediat dhe duhet të jetë e pajisur me një tavolinë të lartë dhe me podium,	<b>20</b>
3	një platformë kamerash, një sistem zanor (mikrofona, folëse dhe kuti shpërndarëse) dhe ndriçimin e duhur për transmetim.	<b>30</b>
4	Stadiumi duhet të ketë në dispozicion një sallë për konferenca për shtyp. Ajo duhet të jetë e pajisur me një tavolinë të lartë dhe me podium, një platformë kamerash mjaftueshëm të madhe për të akomoduar të paktën 8 kamera, një sistem zanor (mikrofona, folëse dhe kuti shpërndarëse me të paktën 16 dalje) dhe ndriçimin e duhur për transmetim.	<b>50</b>

## Neni 38 - ZONA PËR PËRDORIM TË NDRYSHËM (MIKS ZONE)

**38.1** Stadiumet duhet të kenë një zonë midis dhomave të zhveshjes dhe zonës së transportit të ekipeve ( e rezervuar për autobusët e ekipit) që mund të shndërrohen në një zonë për përdorim miks, ku përfaqësuesit e akredituar të mediave mund të intervistojnë lojtarët dhe trajnerët pas ndeshjes.

**38.2** Gjithashtu, kjo zonë për përdorim miks duhet të plotësojë kërkesat e mëposhtme:

KATEGORIA	
1 deri në 3	Nuk ka
4	Të jetë e mbuluar dhe mjaftueshëm e madhe për të akomoduar të paktën 50 përfaqësues të mediave.



# V - Dispozitat Përfundimtare

## Neni 39 - MOSRESPEKTIMI

**39.1** Çdo shkelje e kësaj rregullore do të penalizohet nga FSHF në përputhje me KDS.

## Neni 40 - SHTOJCAT

**40.1** Të gjitha shtojcat janë pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje.

## Neni 41 - ZBATIMI

**41.1** Administrata e FSHF gëzon të drejtën të miratojë çdo udhëzim, direktivë, manual, udhëzues ose çdo instrument tjetër për të ndihmuar në zbatimin e kësaj rregulloreje.

**41.2** Shoqatat dhe klubet do të informohen rregullisht për ekzistencën dhe lëshimin e mjeteve të tilla informative me anë të një letre qarkore.

## Neni 42 - MIRATIMI, HYRJA NË FUQI DHE SHFUQIZIMI


**42.1** Kjo rregullore u miratua nga Komiteti Ekzekutiv i FSHF në mbledhjen e tij të zhvilluar më datë 27 Mars 2025 dhe hyn në fuqi me 01 Qershor 2025.

**42.2** Kjo rregullore zëvendëson Rregulloren e FSHF-së për Infrastrukturën e Stadiumeve të Futbollit 2019.

Armand DUKA  
President

Ilir SHULKU  
Sekretar i Përgjithshëm





**VIJA E KUQE  
TREGON POZICIONIN  
E REKLAMAVE NE  
FUSHËN E LOJËS.**

**VIJA E  
ZEZE TREGON  
RRETHIMIN E  
BRENDSHËM TE  
STADIUMIT MBAS SE  
CILËS QËNDROJNË  
TIFOZËT.**

**VIJA JESHILE  
TREGON ZONEN  
TEKNIKE DHE  
VENDVENDOSJEN E  
BANKINAVE.**

## SHTOJCA A - PËRLOGARITJA E NDRIÇIMIT MESATAR TË PROJEKTORËVE (shih Nenet 16.01 dhe 16.02)

### A.1 PËRKUFIZIMET E TERMAVE

**Ndriçimi horizontal:** Ndriçimi që bie në një plan horizontal 1 metër në lartësi dhe paralel me sipërfaqen e lojës.

**Ndriçimi vertikal:** Ndriçimi që bie në një plan vertikal 1 metër në lartësi dhe pingul me sipërfaqen e lojës.

**Njëtrajtshmëria:** Njëtrajtshmëria e ndriçimit për sa i përket mënyrës se si drita shpërndahet në mënyrë të barabartë në një plan të caktuar referencë. Njëtrajtshmëria e ndriçimit shprehet duke përdorur dy shkallë ndriçimi: U1 dhe U2.

U1	Gama e ndriçimit total, nga minimumi në maksimum, që një person ose kamera do të ekspozohet. Vlera U1 kontribuon në performancën vizuale
U2	Diferenca mes ekspozimit normal të përshtatur të një personi dhe nivelit më të ulët të ndriçimit në planin e dhënë. Vlera U2 kontribuon në komoditetin vizual.
LUX	Njësia e incidentit të ndriçimit në një sipërfaqe loje ( $1lx = 1lm/m^2$ ).
E	Sasia e dritës që bie mbi një sipërfaqe në një pikë të caktuar, e matur në lux.

## A.2 TESTIMI

**Pajisjet e testimit:** Matësi i ndriçimit i përdorur për testin e ndriçimit duhet të jetë i përshtatshëm për një mjedis të ndriçuar me projektor, me një sensor drite pritëse me kënd të gjerë. Matësi duhet të rikalibrohet çdo vit.

**Procedura e testimit:** Fusha e lojës ndahet në një rrjet që përmban 96 pika. Në secilën pikë, kryhet një test ndriçimi për të matur ndriçimin horizontal (në një kënd) dhe ndriçimin vertikal (në katër kënde të ndryshme). Për rrjedhojë, gjatë procedurës së testimit duhet të kryhen në total 480 teste ndriçimi. Matësi i ndriçimit duhet të jetë gjithmonë i pozicionuar në këndin e duhur për matjen e synuar. Personeli që kryen testin nuk duhet të krijojë asnjë hije që mund të komprometojë leximet e matësit. Matësi duhet të jetë 1 metër mbi sipërfaqen e lojës. Leximi i matësit të ndriçimit për secilën pikë të rrjetit duhet të regjistrohet në planin përkatës të rrjetit të ndriçimit.

**Testi horizontal:** Matësi pozicionohet me pamje nga sipër, 1 metër mbi sipërfaqen e lojës, dhe paralel me fushën, në çdo pikë të rrjetit.


**Testimi vertikal:** Matësi pozicionohet pingul me fushën, 1 metër mbi sipërfaqen e lojës, në çdo pikë të rrjetit. Matësi duhet të rregullohet për secilën nga katër pozicionet e testimit. Pozicionet e testimit shënohen në planin e rrjetit vertikal të ndriçimit dhe caktohen në  $0^\circ$ ,  $90^\circ$ ,  $180^\circ$  dhe  $270^\circ$ . Kjo procedurë duhet të përsëritet në të gjitha 96 pikat e rrjetit.

Shkalla e njëtrajtshmërisë llogaritet si më poshtë:

**U1:** E min/E max

**U2:** E min/E med

## SHTOJCA B - ORGANIZIMI I FUSHËS *(shih Nenin 5.07)*



## SHTOJCA C - PËRMASAT E INFRASTRUKTURËS SË EKIPEVE U7-U19 (Amator & Profesionist)

	U7	U9	U11	U13	U15	U17	U19
Përmasat	20x40	20x40	45x60	50x80	60x100	64x105	64x105
Lartësia e Rrethimi	<b>2.5-3</b> m						
Largësia e Rrethimit	<b>2.5-3</b> m nga vijat e fushës së lojës						









FEDERATA  
SHQIPTARE E  
FUTBOLLIT

ADRESA: SHTËPIA E FUTBOLLIT,  
RRUGA: "LIMAN KABA", NR. 5  
KODI POSTAR 1019, TIRANA, ALBANIA  
TELEFON: +35542 346 601  
FAX: +35542 346 609  
E-MAIL: [INFO@FSHF.AL](mailto:INFO@FSHF.AL)

---